BEQIR META

SHTETËZIMI I SHKOLLAVE PRIVATE GREKE DHE REAGIMI I MINORITETIT

Abstrakt:
Në këtë artikull synohet që të jepet një pasqyrim i qartë dhe i përmbledhur i çështjes së shtetëzimit të shkollave private greke nga shteti shqiptar në vitet 1930, i qëndrimit të minoritetit grek si dhe i shtetit grek ndaj kësaj çështjeje. Që në krye të artikullit, autori sqaron se mbyllja nga qeveria shqiptare e shkollave private, nuk drejtohej kurrsesi kundër minoritetit grek në Shqipëri, por synimi i shtetit shqiptar ishte që të pengonte ndërhyrjen dhe presionin në rritje të qeverisë italiane, por njëherësh edhe të disiplinonte arsimin në minoritetin grek, të eliminonte ndërhyrjen e hapur greke në këto shkolla dhe në zonën e minoritetit, veçanërisht, propagandën antishqiptare që zhvillonin mësuesit e paguar nga Greqia. Pas ankesës së paraqitur nga grekët në Lidhjen e Kombeve dhe në Gjykatën e Hagës, kjo çështje merr një drejtim tjetër, dhe autori arrin në përfundime të rëndësishme lidhur me qëndrimin që mbajti qeveria shqiptare.

Fjalë kyçe:
Shqipëria, Greqia, shkolla private greke, minoriteti grek, qeveria shqiptare, qeveria greke, konsullata greke, Këshilli i Lidhjes së Kombeve, Gjykata Ndërkombëtare e Hagës

Shtetëzimi i shkollave në zonën e minoritetit grek

Në betejën që po zhvillonte me qeverinë italiane për të penguar ndërhyrjen dhe presionin në rritje të saj, qeveria shqiptare kundërveproi duke marrë masa për mbylljen e shkollave italiane në Shqipëri në të cilat zhvillohej edhe propagandë fashiste. Për të realizuar këtë qëllim, ajo, në prill të vitit 1933 ndryshoi dy nene të Statutit Themeltar të Mbretërisë, duke e ndaluar arsimin privat dhe duke e vënë atë nën kontrollin dhe

drejtimin e shtetit shqiptar. Është e kuptueshme se, me këtë masë, qeveria shqiptare donte të disiplinonte edhe arsimin në minoritetin grek, të eliminonte ndërhyrjen e hapur greke në këto shkolla dhe në zonën e minoritetit, veçanërisht, propagandën antishqiptare që zhvillonin mësuesit e paguar nga Greqia.

Ministria e Arsimit, duke aplikuar dispozitat e Statutit Themeltar, pushoi nga puna mësuesit e gjuhës greke që nuk dinin shqip dhe ata që nuk kishin arsimin përkatës. Kjo masë nuk bëri përshtypje të mirë në fshatrat greke. Disa vite më parë, Ministria e Arsimit kishte nxjerrë urdhëresa që mësuesit e padiplomuar dhe ata që nuk dinin gjuhën zyrtare t'u nënshtroheshin kurseve kualifikuese. Ajo e kishte zgjatur disa vite afatin e shlyerjes së provimeve nga mësuesit me qëllim që t'i ndihmonte ata të kualifikoheshin. Deri në vitin 1933, një pjesë e mësuesve i kaloi me sukses këto provime dhe ata të gjithë u punësuan, kurse pjesa tjetër, ose i refuzoi, ose nuk arriti t'i kalonte ato. Pas ndryshimit të Statutit të gjithë mësuesit privatë që kishin pasur cilësitë që përcaktonte ligji dhe që kishin bërë kërkesë u emëruan mësues zyrtarë. Ministria e Arsimit mori masa që t'i plotësonte të gjitha shkollat e minoritetit edhe në ato katunde ku më parë kishte pasur shkolla private, me personelin e nevojshëm arsimor që dinte gjuhën greke dhe atë shqipe. Kështu shtetëzimi solli edhe përmirësimin e cilësisë së personelit arsimor, i cili ishte i kualifikuar dhe, në bazë të ligjit, paguhej më mirë. Shumica e mësuesve të shkollave private greke kishin pasur dëftesën e përfundimit të një shkolle fillore ose të një shkolle plotore (qytetëse). Një pjesë e vogël prej tyre kishte përfunduar edhe ndonjë klasë gjimnazi të huaj. Ndërsa, shumica e mësuesve në shkollat greke shtetërore që u punësuan pas shtetëzimit kishte kryer mësimet në shkolla normale ose në lice dhe gjimnaze. Një pakicë prej tyre përbëhej prej mësuesve të mëparshëm privatë të shkollave greke, të cilët kishin pranuar t'i shërbenin shtetit. Ata i ishin nënshtruar në vitin 1932 provimit të aftësisë pedagogjike.[1]

Në ankesën që grekët i paraqitën Lidhjes së Kombeve thuhej se numri i shkollave greke të mbyllura ishte 350. Në të vërtetë ky ishte një falsifikim, sepse ishte dhënë shifra e të gjitha shkollave greke që funksiononin para vitit 1912 në vilajetin e Janinës, në një pjesë të vilajetit

[1] *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ)*, viti (më tej: V.) 1934, dosja (më tej: D.) 255, fl.138. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

të Manastirit dhe në nënprefekturën e Durrësit.[2] Kërkesa për 350 shkolla greke nuk pasqyronte as gjendjen e mëparshme të shkollave private në zonën e minoritetit dhe as nevojën e tij për këto shkolla, por ajo ishte një kërkesë e qeverisë greke, e cila synonte të shfrytëzonte rastin e krijuar për t'i imponuar qeverisë shqiptare çeljen e shkollave greke që kishin funksionuar në Shqipërinë e Jugut gjatë periudhës së sundimit turk ose më e pakta të disinformonte Lidhjen dhe të nxiste reagimin e saj kundër veprimit të qeverisë shqiptare. Autoritetet shqiptare informonin se telegrami i minoritarëve nuk ishte nisur nga zyrat telegrafike shqiptare. Ato gjithashtu përgënjeshtronin pretendimin e telegramit dhe të qarqeve greke se ishin bërë shtrëngime ndaj popullsisë greke dhe shkelje të tjera nga ana e organeve shtetërore, pasi ato ishin sjellë krejtësisht në mënyrë korrekte me këtë popullsi.[3]

Neni 19 i Ligjit Organik të Arsimit, i vitit 1928, përcaktonte se për hapjen e një shkolle fillore, një katund duhej të kishte të paktën 25 nxënës në moshën shkollore (prej 7-13 vjeç). Duke pasur parasysh se nxënësit e kësaj moshe, përgjithësisht, arrinin deri në 10% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, duhej që ky fshat të kishte rreth 250 banorë. Kjo dispozitë ligjore që u zbatua në periudhën e parë të organizimit të arsimit në Shqipëri, ishte e diktuar nga mungesa e personelit dhe nga vështirësitë financiare. Për këto arsye, me përjashtim të disa katundeve greke, në pjesën tjetër të vendit fshatrat me 250-300 banorë nuk kishin shkolla. Për të plotësuar pjesërisht këtë nevojë, Ministria e Arsimit kishte hapur një numër konviktesh të arsimit fillor, në të cilat strehonte fëmijët e katundeve pa shkolla. Por, kjo dispozitë ligjore u zbatua me tolerancë në favor të minoritetit grek. Nga 72 katunde që figuronin në protestën e grekëve, 41 kishin më pak se 250 banorë. Megjithëkëtë, 11 prej tyre e kishin të siguruar mësimin në shkollat fillore greke.

Megjithëse u mbyllën disa shkolla në fshatrat greke ku numri i nxënësve ishte fare i vogël, shkollat në zonën e minoritetit ishin më të shumta se në zonat e tjera të vendit. Numri i shkollave në raport me numrin e fshatrave dhe qyteteve shqiptare ishte 20%, ndërsa ky raport për katundet greke ishte 63%.[4] Në vitin shkollor 1934-1935 kishte 39

[2] *Po aty*, V. 1934, D. 255, fl.122. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Ministrisë së Arsimit, 16 prill 1934.

[3] *Po aty*, fl.123. Ministria e Punëve të Brendshme për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 28 prill 1934.

[4] *Po aty*, fl.138. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

katunde greke pa shkolla në qendrat e tyre, të cilat kishin 7 288 banorë.[5] Ndërsa numri i katundeve greke që kishin shkollë ishte 54. Ato kishin një popullsi prej 29.929 vetash me 3.692 nxënës dhe 58 mësues.[6]

Për të kuptuar gjendjen e vërtetë të arsimit në zonën e minoritetit, Ministria e Arsimit hartoi edhe këto pasqyra krahasuese për situatën e arsimit në Shqipëri dhe në Greqi:

a. Statistika e nxënësve shqiptarë e grekë[7]

Popullsia	Shqiptarë	Grekë
Popullsia (regjistrimi i vitit 1930)	965 573	37 217
Fëmijë të moshës së shkollës fillore	125 000	4 652
Popullsia që ka shkollë	363 424	29 929
Nxënës që ndjekin shkollën	45 378	3 692
Përqindja e nxënësve në raport me fëmijët në moshën e detyrimit shkollor	36,29 %	79,30 %
Përqindja e nxënësve në raport me popullsinë e përgjithshme	4,8 %	9,9 %

b. Statistikë e nxënësve grekë të Shqipërisë dhe e nxënësve të Greqisë[8]

	Minoriteti grek në Shqipëri	Greqia
Popullsia	37 217	6 204 684
Nxënës në moshën e detyrimit shkollor	4 652	851 676
Nxënës që frekuentojnë shkollën	3 692	636 708
Përqindja e frekuentuesve	79,30 %	75 %

Meqenëse çështja e shkollave mori një karakter ndërkombëtar, qeveria shqiptare u përpoq të shpjegonte dhe të mbronte politikën e saj.

[5] *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH)*, Fondi (më tej: F.): Ministria e Arsimit, viti (më tej: V.) 1934, dosja (më tej: D.) 550, fl.7. Listë e katundeve grekofone që nuk kishin shkolla.

[6] *Po aty*, F. Ministria e Arsimit, V. 1934, D. 550, fl.5-6. Pasqyrë e katundeve grekofone që kanë shkollë fillore tërësisht në gjuhën greke.

[7] *Po aty*, fl.19.

[8] *Po aty*, fl.20.

Ajo bëri një deklaratë të gjatë, në të cilën parashtronte gjerësisht qëndrimin e vet.[9]

Statistikat që i kishin paraqitur grekët Lidhjes së Kombeve, qëllimisht, paraqisnin si shkolla private numrin global të shkollave private e shtetërore dhe të mësuesve të shtetit e privatë, me përjashtim të vitit 1932-1933, në statistikën e të cilit nuk ishin përfshirë mësuesit dhe shkollat zyrtare.

Për të qartësuar situatën e mëparshme të arsimit në minoritetin grek Ministria e Arsimit jepte këtë statistikë të numrit të shkollave greke private e shtetërore:

Viti shkollor	Shkolla publike	Shkolla private	Totali	Mësues të shtetit	Mësues privatë	Totali
1925-1926	21	30	51	24	48	72
1926-1927	20	33	53	23	50	73
1927-1928	25	31	56	26	49	75
1928-1929	23	29	52	29	52	81
1929-1930	20	28	48	26	35	61
1930-1931	29	28	57	32	47	79
1931-1932	27	22	49	27	55	82
1932-1933	40	10	50	53	11	64
1933-1934	45	-	45	70	-	70

Pakësimi i shkollave private dhe i mësuesve të tyre në vitin 1932-1933 para shtetëzimit, kishte ndodhur si rezultat i mungesës së personelit të aftë pedagogjik. Por ky pakësim u kompensua me hapjen e 13 shkollave të reja shtetërore kundrejt 12 shkollave private të mbyllura dhe me shtimin e 26 mësuesve zyrtarë.

Shtetëzimi i shkollave private në vitin 1933-1934 u bë në zbatim të ndryshimeve në Statutin Themeltar, i cili përcaktoi mbylljen e të gjitha shkollave private. Por, kujdesi i qeverisë shqiptare u demonstrua me shtimin e 5 shkollave të reja dhe të 17 mësuesve. Gjendja financiare, në kulmin e krizës ekonomike që po kalonte vendi, pengoi që numri i shkollave e i mësuesve të rritej edhe më shumë, kjo edhe për arsyen se ky ishte viti i parë i shtetëzimit të të gjitha shkollave private të Shqipërisë. Ky shtetëzim e detyroi Ministrinë e Arsimit të merrte përsipër pagesën e të gjithë personelit arsimor dhe të mbajtjes së shkollave të vendit.

[9] *Po aty*, F. Ministria e Arsimit, V. 1934, D. 378, fl.1-11. Deklaratë e qeverisë shqiptare për shkollat greke, 22 maj 1934.

Qysh prej vitit 1925 deri në vitin 1933 qeveria shqiptare kishte shpenzuar për shkollat greke 40-60 mijë fr.ari çdo vit. Në vitin 1933-1934, kur u bë shtetëzimi, vetëm për rrogat e mësuesve të shkollave greke, ajo harxhoi 121 000 fr. ari, ndërsa shuma e pagave të mësuesve të shkollave fillore të të gjithë Shqipërisë ishte 1 600 000 fr. ari.

Qeveria shqiptare pohonte se ajo nuk kishte pasur asnjëherë si qëllim që të mbyllte shkollat private greke dhe as që të ndrydhte arsimimin e grekëve. Po ta kishte pasur këtë qëllim ajo mund t'i kishte mbyllur më parë shkollat private greke edhe për arsyen se shpenzimet e tyre nuk paguheshin nga komuniteti vendas grek. Ajo e kishte të qartë se këto katunde të vobekta e me pak banorë nuk ishin në gjendje të mbanin me mjetet e veta financiare shkollat private e të paguanin mësuesit privatë.

E vetmja kritikë që mund t'i bëhet këtyre masave ishte ulja e orëve të mësimit në gjuhën greke fillimisht në 4 dhe më pas në 6 orë në javë. Më parë mësimi në shkollat private zhvillohej në të gjitha lëndët në greqisht. Ndonëse kjo masë me karakter të qartë nacionalist do të korrigjohej më vonë dhe të gjitha lëndët mësimore do të mësoheshin në gjuhën greke, ajo krijoi shqetësime të ligjshme dhe gjithashtu i shërbeu shumë propagandës greke për të ngritur alarmin dhe për të forcuar argumentet kundër qeverisë shqiptare. Gjithsesi po të krahasohet me qëndrimet e qeverisë greke ndaj minoritetit shqiptar në Greqi, kjo ishte vetëm një shkelje e vogël.

Reagimi i popullsisë minoritare kundrejt shtetëzimit të shkollave private

Fillimisht u duk se masa e re nuk shkaktoi reagimin e minoritetit grek.[10] Mirëpo nuk do të vononte shumë dhe do të vinte edhe kundërpërgjigjja, jo nga komuniteti minoritar, por nga qarqet politike të shtetit fqinj. Konsullata greke e Gjirokastrës po zhvillonte një aktivitet të ngjeshur për të përgatitur kundërgoditjen ndaj masave të qeverisë shqiptare. Fillimisht, ajo u përpoq ta mbante të gjallë shpresën dhe dëshirën e grekëve për rihapjen e shkollave private duke i informuar se

[10] H. Tuqi, "Disa dit në Pogon", *Demokratia,* Gjirokastër, 20 maj 1933.

qeveria shqiptare do të tërhiqej.[11] Në hapat e parë rezistenca e popullsisë greke ishte pasive. Gati në të gjitha lëndët kryesore, mësimet po vijonin fshehurazi në gjuhën greke. Ministri i Arsimit i asaj kohe, Mirash Ivanaj, i cili ziente nga dëshira nacionaliste për ta shtetëzuar arsimin grek dhe për ta shqiptarizuar atë, pohonte se megjithëkëtë, Ministria e Arsimit nuk dëshironte momentalisht t'i kundërpërgjigjej kësaj sfide që po i bëhej nga mësuesit të cilët, duke qenë nëpunës të shtetit shqiptar, "po viheshin në shërbim të të huajve".[12] Ministria vendosi të lejonte mësimin e gjuhës greke si mësim gjuhe me 4 orë në javë, duke filluar nga klasa e dytë e lart. Të gjitha lëndët e tjera që përfshinte Neni 6 i Ligjës Organike të Arsimit do të zhvilloheshin tërësisht në gjuhën shqipe dhe me tekste të botuara e të pranuara prej asaj ministrie.[13]

Në fillim të vitit 1934, problemi i shkollave filloi të bëhej më i mprehtë. Promotorë të kësaj lëvizjeje ishin, si gjithnjë, konsullatat greke. Prefektura e Gjirokastrës informonte se konsulli grek i atjeshëm kishte udhëzuar pleqësitë e disa katundeve greke që të përgatisnin ankesa drejtuar Lidhjes së Kombeve, së cilës do t'i kërkonin shkolla private greke dhe jo shkolla me mësues zyrtarë, të cilët jepnin vetëm 4 orë mësimi greqisht në javë.[14] Ministria e Brendshme u kundërpërgjigj, duke u përpjekur të merrte masa për ndalimin e çdo lloj proteste që mund të bënin grekët për çështjen e shkollave.[15]

Nga ana tjetër, autoritetet vendore po merrnin informacione shqetësuese. Nënprefekti i Libohovës, Hasan Delvina, informonte se konsulli grek i Gjirokastrës u kishte kërkuar pleqësive të katundeve greke një listë të personave të aftë për të mbajtur armë. Ai u kishte thënë atyre se në qoftë se do të ishte nevoja, shkollat do t'i çelnin edhe me armë dhe se qeveria greke do t'i shpërndante ato për të armatosur minoritetin grek. Ai kishte shtuar se, "neve jemi në gjendje ta copëtojmë krejt Shqipërinë,

[11] *AQSH*, F. MPB, V. 1933, D. 247, fl.115. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 nëntor 1933.

[12] *Po aty*, F. MPB, V. 1933, D. 247, fl.159-160. Ministria e Arsimit drejtuar shkollave fillore: Gjirokastër, Libohovë, Delvinë, 30 dhjetor 1933.

[13] *Po aty*.

[14] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.8. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 15 janar 1934.

[15] *Po aty*, fl.12. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 25 janar 1934.

nëse nuk i plotëson kërkesat tona".[16] Zëvendësprefekti i Gjirokastrës, Tasim Bishqemi e mori me rezervë këtë informacion, por ai ishte i shqetësuar se protestat mund t'i dërgoheshin Lidhjes së Kombeve, përmes konsullatave greke dhe se kjo iniciativë vështirë se mund të bllokohej. Ai propozonte marrjen e masave për internimin e disa drejtuesve të kësaj lëvizjeje dhe sidomos për tregtarin Vasil Shahini, por Ministria e Brendshme i kundërshtoi këto kërkesa.[17]

Disa ditë më vonë, Bishqemi informoi se vetëm pak banorë të 10-15 katundeve të Dropullit kishin nënshkruar ankesën. Nënshkruesit ishin kryesisht ish mësues privatë dhe një pjesë fare e pakët e popullsisë. Protestat pastaj ishin dërguar në konsullatën greke, e cila i kishte nisur për në Janinë.[18] Gjithashtu edhe pleqësitë e fshatrave Halo, Metoq, Çukë e Çaush, të nxitur prej ish mësuesit privat Stavro Joanidhi, i vulosën protestat në gjuhën greke që i dërgoheshin Lidhjes së Kombeve dhe i dorëzuan në konsullatën greke.[19] Nënprefektura e Sarandës informonte se grekët e atij qarku nuk kishin kurajë civile për të filluar një lëvizje të tillë, por ata ishin nxitur nga propaganda që zhvillonin konsullata greke së bashku me agjentët e shoqërive "vorio-epirote". Ajo e konsideronte nënshkrimin e këtyre peticioneve si hapin e parë të një lëvizjeje aktive që zhvillohej dhe do të zhvillohej hera-herës për realizimin e këtij qëllimi. Prandaj, ajo kërkonte leje për të kryer disa internime të këtyre agjentëve, në bazë të artikullit 1 të Ligjit Ndëshkimor për Fajet Politike.[20] Edhe prefektura e Gjirokastrës informonte se ato ditë agjentët grekë ishin në lëvizje. Ajo propozonte arrestimin e 3-4 agjentëve kryesorë, si tregtarin Vasil Shahini, avokatin Tasho Loli etj.[21]

---

[16] *Po aty*, fl.95. Nënprefekti i Libohovës, Hasan Delvina, drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 24 janar 1934.

[17] *Po aty*, fl.21. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 26 janar 1934.

[18] *Po aty*, fl.23. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 28 janar 1934.

[19] *Po aty*, fl.29. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 30 janar 1934.

[20] *Po aty*, fl.38. Nënprefektura e Sarandës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 1 shkurt 1934.

[21] *Po aty*, fl.31. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 31 janar 1934.

Prefektura e Gjirokastrës përgatiti në fund të janarit 1934 një raport të plotë për situatën, të cilin ia dërgoi Ministrisë së Brendshme.[22] Ajo pohonte se konsullata greke e Gjirokastrës tashmë ishte në gjendje të zhvillonte çdo lloj propagande në popullsinë greke me anën e agjentëve të saj, sipas dëshirave dhe qëllimeve greke. Ajo kishte gjetur fushë të lirë, pasi kundër agjenturës greke nuk ishte marrë më parë asnjë masë. Ata po e përdornin minoritetin grek sipas planeve të Athinës. Madje, po gjenin përkrahës edhe tek ata që nuk ishin grekë për të realizuar qëllimin e tyre. Këtë situatë ajo e cilësonte tërësisht pasojë të indiferencës së autoriteteve shtetërore në të kaluarën, të cilat nuk kishin marrë masa kundër agjentëve dhe propagandistëve grekë. Madje, ishin ndërmarrë disa masa administrative të bujshme që kishin përfunduar pa asnjë veprim konkret. Kështu ishte shtuar numri i bashkëpunëtorëve të konsullatës greke dhe popullsia minoritare e kishte përvetësuar pa asnjë frikë propagandën greke.

Porsa filluan dyshimet për mbylljen e shkollave private, qeveria greke, e informuar prej agjentëve të saj me pozitë në shtetin shqiptar, kishte zëvendësuar konsujt e saj të Gjirokastrës e Sarandës me njerëz më aktivë e me eksperiencë. Ata i shtuan dhe i forcuan shumë kontaktet me popullsinë minoritare. Në heshtje dhe në fshehtësi, konsullata dhe agjentët grekë organizuan nënshkrimin e peticioneve drejtuar Lidhjes së Kombeve.[23] Komanda e xhandarmërisë së Gjirokastrës informonte se nënkonsullata greke e Gjirokastrës, me agjentët e saj, kishte mundur të vuloste me shpejtësi telegramin e protestës në disa katunde minoritare të rajonit të Libohovës, në 7-8 katunde greke të Gjirokastrës dhe në disa katunde të Sarandës. Protestën e kishin nënshkruar kryepleqtë, ish mësuesit privatë dhe ndonjë banor. Aktivistët kryesorë dr. Kiçati, avokat Kristul Joçka, avokat Tasho Loli dhe sekretari i konsullit Vasil Shahini, kishin shëtitur katund më katund, duke bërë propagandë për të inkurajuar popullsinë greke të nënshkruante protestat.[24]

Autoritetet shqiptare u informuan me vonesë për këtë lëvizje. Peticionet kishin edhe nënshkrime false kur nuk mund të siguronin firmat e popullsisë minoritare. Konsullata kishte bindur grekët se, në mos me të

---

[22] *Po aty*, fl.68-72. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 31 janar 1934.

[23] *Po aty.*

[24] *Po aty*, fl.81-83. Komanda e xhandarmërisë së Gjirokastrës drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 3 shkurt 1934.

mirë, çështja e shkollave do të fitohej edhe me armë. Prefektura hidhte dyshime se në këtë çështje ishte edhe "gishti italian". Ajo tërhiqte vëmendjen se disa të dhëna, si pohimet e konsullit grek se brenda një nate do të armatosej e gjithë popullsia greke (gjë që nuk ishte e mundur); ardhja e Koço Tasit në Janinë; lajmet e tjera se në Korçë e në Përmet kishte pasur të shtëna armësh; informacionet se Greqia po forconte kufirin; lëvizjet e agjentëve grekë e sidomos mosardhja prej dy javësh e konsullit grek në prefekturë; duheshin vlerësuar me kujdes, pasi ato mund të ishin veprime demonstrative për të inkurajuar lëvizjet e minoritarëve, të cilët, përgjithësisht, ishin një popullsi paqësore.

Meqë katundi Derviçan konsiderohej si çerdhja e propagandës helenizuese, saqë edhe publikisht thuhej se "Derviçani është një Greqi e Vogël", u propozua vendosja e një roje të xhandarmërisë në këtë fshat për të dekurajuar agjentët grekë.[25] Prefektura e Gjirokastrës propozonte që ish mësuesit privatë të shkollave greke që kishin mbaruar shkolla normale dhe e dinin gjuhën shqipe shumë mirë, të emëroheshin si mësues në katundet muhamedane jashtë qarkut të Gjirokastrës. Në këtë mënyrë, ata do të siguronin jetesën dhe do t'i pritej hovi propagandës që bëhej për shkollat greke. Gjithashtu, ajo kërkonte që të sigurohej urgjentisht mësimi i gjuhës greke nga mësues të aftë dhe të shtoheshin orët e mësimit të saj nga 4 orë në javë në 1 orë në ditë.[26] Këtë propozim e mbështeti menjëherë Ministria e Brendshme dhe ajo e Arsimit. Kështu, në mars 1934 u vendos mësimi në gjuhën greke me 6 orë në javë dhe filloi sistemimi i ish mësuesve privatë që dinin gjuhën shqipe në shkolla të tjera.[27] Numri i fëmijëve grekë, të detyruar për arsimin fillor në këtë kohë, ishte afërsisht 2 600. I njëjti numër kishte qenë edhe më parë.[28]

Ministria e Brendshme i kërkoi prefektit të Gjirokastrës të vizitonte qendrat e nënprefekturave, të thërriste të gjithë ata persona që kishin nënshkruar protestën dhe agjentët e tjerë të konsullatave greke e të

[25] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146/2, fl.23. Komanda e xhandarmërisë së qarkut të Gjirokastrës drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 10 shkurt 1934.

[26] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.126-128. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 12 shkurt 1934.

[27] *Po aty*, fl.139. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 23 shkurt 1934; *po aty*, fl.153. Ministria e Punëve të Brendshme për Ministrinë e Arsimit, 29 mars 1934.

[28] *AMPJ*, V. 1934, D. 255, fl.138. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme.

shoqërive "vorio-epirote" dhe, në mënyrë "jo aq të butë", t'u tregonte se çdo propagandë që bëhej me shtytjen e të huajve kundër ligjeve të shtetit do të sillte ndërlikime të rënda.[29] Gjithashtu, ajo porositi që elementët grekë e grekomanë të ndaloheshin për të hyrë në konsullatën greke, me përjashtim të atyre që kishin punë.[30] Në këtë fazë nuk u ndërmorën veprime represive shtrënguese.[31]

Në korrik të vitit 1934 një ekip inspektorësh i Ministrisë së Arsimit kreu një inspektim të hollësishëm në shkollat e katundeve me popullsi greke të prefekturës së Gjirokastrës. Ekipi i inspektorëve arriti në përfundimin se, në përgjithësi, shkollat ishin frekuentuar në rregull, marrëdhëniet e mësuesve shqiptarë me popullsinë vendase ishin të mira dhe miqësore, por në disa shkolla të vogla kishte mungesa për mësues të gjuhës greke dhe në disa shkolla të mëdha kishte lindur nevoja e dërgimit të mësueseve për vajzat. Niveli pedagogjik arsimor i mësuesve shtetërorë ishte i kënaqshëm dhe më i lartë se në krahinat e tjera të vendit.[32]

Por, në një raport tjetër të gjatë të hartuar pas disa ditësh, inspektori i Ministrisë së Arsimit parashtronte edhe ankesat e pretendimet e banorëve të këtyre fshatrave.[33] Ata ishin ankuar se administrata shtetërore ishte sjellë rreptësisht kundrejt tyre, duke mos marrë parasysh asnjë të drejtë e zakon të kësaj popullsie, por kishte vepruar në bazë të interesit shtetëror në trajtimin e problemeve administrative e arsimore. Prandaj kërkonin që mësimi i gjuhës greke të jepej pa përjashtim në të gjithë fshatrat e tyre; që mësuesit e saj të kishin po atë kualifikim si ato që jepnin lëndët në gjuhën shqipe; ishin ankuar se për lëndën e gjuhës greke ishin caktuar disa mësues që e dinin pak gjuhën; kërkonin që gjuha greke të jepej më gjerësisht në lëndët mësimore; ankoheshin se disa mësues që kishin mbaruar shkolla normale ose gjimnaze greke dhe që dinin shqip, ishin lënë jashtë shërbimit, ose ishin caktuar në fshatra larg fshatit të tyre. Ata kërkonin që këto mësues të cilët ishin të aftë të merreshin në punë

[29] *AQSH*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.51. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 2 shkurt 1934.

[30] *Po aty*, fl.67. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 5 shkurt 1934.

[31] *Po aty*, fl.83. Komanda e xhandarmërisë së Gjirokastrës drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 3 shkurt 1924.

[32] *Po aty*, F. 368, V. 1934, D. 9, fl.9-32. Raport mbi shkollat e katundeve me popullsi grekofone të prefekturës së Gjirokastrës, viti shkollor 1933-1934, 26 korrik 1934.

[33] *Po aty*, fl.33-50. Raport mbi rregullimin e shkollave të katundeve të qarkut Gjirokastër, të cilat kanë popullsi grekofone, 31 korrik 1934.

dhe të tjerët që nuk e dinin gjuhën shqipe të dërgoheshin në shkolla normale shtetërore ku të mësonin gjuhën shqipe.

Banorët ankoheshin se, me pak përjashtime, të gjithë mësuesit e parë ose kryemësuesit ishin myslimanë dhe, nga kjo, ata kishin arritur në përfundimin se qeveria nuk kishte besim tek mësuesit grekë por nuk kishte besim as tek mësuesit e tjerë shqiptarë të krishterë, të cilët i kishte lënë nën autoritetin e mësuesve myslimanë. Në fakt raportet zyrtare e përgënjeshtronin këtë pretendim. Ata nuk dëshironin që të kishte klasa me djem e vajza bashkë por kërkonin klasa më vete për vajzat dhe mësuese që t'i mësonin ato. Lëndës së besimit fetar nuk i ishte dhënë rëndësi dhe nuk ishte dhënë në shkolla. Kërkonin që të lejohej fshati të paguante një mësues ortodoks që ta jepte këtë lëndë.

Inspektori i lartpërmendur i sugjeronte Ministrisë së Arsimit që mësuesit e kësaj krahine të përpiqeshin të siguronin simpatinë e banorëve vendas, të shoqëroheshin e të qëndronin në kontakt me ta; të shmangnin çdo provokim e veprim ekstremist, apo konflikt me vendasit dhe të ishin tolerantë.

Ai informonte edhe për ngatërresat që po përpiqeshin të krijonin agjentët e konsullatës greke, veçanërisht në fshatin Derviçan dhe propozonte që disa vajzave e djemve të vobektë të kësaj zone minoritare t'u jepeshin bursa nga shteti për të ndjekur shkollat e mesme. Duke parë nivelin e lartë dhe gjendjen e mirë të shkollave greke, ai propozonte që t'u jepej rëndësi edhe fshatrave shqiptare që shkollat e tyre të organizoheshin në këtë nivel, me personel të seleksionuar e të ndershëm.

E ndodhur nën presionin e jashtëm të fortë, Ministria e Arsimit filloi të bënte lëshime. Ajo autorizoi mësimin e gjuhës greke edhe në 13 shkolla të tjera fillore të grekëve.[34] Në këtë mënyrë në vitin shkollor 1934-35 mësimi i greqishtes do të jepej në 35 shkolla greke.[35] Përveç këtyre 35 katundeve, në qendrat e të cilëve gjendeshin shkollat, këto do të ndiqeshin edhe prej fëmijëve të fshatrave të afërta me to. Kështu, mësimi i gjuhës greke do të bëhej në 51 katunde greke.

Në këto shkolla nga 34 mësues që ishin ngarkuar për mësimin e greqishtes, 11 ishin grekë dhe 25 të tjerë kishin mësuar në shkollat greke. Të gjithë ishin ortodoksë, vetëm njëri ishte mysliman. Numri i

[34] *AMPJ*, V. 1934, D. 255, fl.155. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 26 shtator 1934.

[35] *Po aty*; *AQSH*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.178. Qarkore rezervate e Ministrisë së Arsimit, 25 shtator 1934.

përgjithshëm i mësuesve në këto shkolla ishte 80. Libra mësimi për shkollat greke u përdorën ato të vitit të mëparshëm.[36]

Gjatë muajit shtator 1934, situata në zonën e minoritetit ishte mjaft e turbullt dhe po shfaqeshin shenjat e fillimit të një bojkoti të shkollave. Kryepleqtë dhe banorët e disa fshatrave si Derviçani, Goranxia, Vanishta, Dhuvjani i deklaruan autoriteteve vendore se nuk do t'i dërgonin fëmijët në shkollë në qoftë se gjuha greke dhe mësimi i fesë nuk bëhej me mësues privat të komunitetit grek. Autoritetet e Gjirokastrës ishin të shqetësuara se lëvizja mund të përhapej edhe në fshatra të tjera minoritare.[37] Në Bularat prifti frikësonte banorët me kërcënime fetare në qoftë se ata do t'i çonin fëmijët në shkollë.[38] Akoma më shqetësuese ishin informacionet që jepte inspektori i Arsimit të Gjirokastrës. Ai kishte hetuar në fshatin Sotirë se lëvizja, jo vetëm do të përhapej edhe në krahinat Pogon, Delvinë, Konispol e Himarë, por se grekët po kërkonin zbatimin e Protokollit të Korfuzit dhe se prisnin ardhjen e një Komisioni Hetimor të Lidhjes së Kombeve.[39]

Në këtë situatë, autoritetet shtetërore shqiptare morën disa masa të vakëta. Ata internuan në Elbasan pesë ish mësues privatë që kishin qenë ndër nxitësit kryesorë të kësaj lëvizjeje.[40] Komisioni shkollor në Jergucat gjobiti disa prindër në 2-3 katunde për mosdërgimin e fëmijëve në shkollë por ata nuk pranuan të paguanin gjobën.[41] Në fund të shtatorit 1934, prefektura e Gjirokastrës i propozoi Ministrisë së Brendshme mbylljen e atyre shkollave ku nuk dërgoheshin fëmijët dhe marrjen e masave ndëshkimore kundër propagandistëve të kësaj lëvizjeje. Mirëpo

---

[36] 1-5. *Gramatiki tis Matrikis glossis, II, III, IV, V, VI.* En Konstantinopolei, Bibliopoleion I.K. Chejtanidhi, en Galata odo Mahmoudije arith. 7-9, 1902.
6. *Trion Didaskaliston. Neonelinikon anagnostikon "Patris"* Etos A. Tefhos A. En Konstantinopolei, Bibliopoleion I.K. Chejtanidhi, en Galata odo Mahmoudije arith.7-9, 1921.
7. *Trion Didaskalistou. Neon elenikon anagnostikon "Patris"*. Etos A. Thefhos B. En Konstantinopolei, Bibliopoleion I.K. Chejtanidhi, en Galata odo Mahmoudije arith. 7-9, 1920.

[37] *AQSH*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.194. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 28 shtator 1934.

[38] *Po aty*, fl.209.

[39] *Po aty*, fl.213. Inspektori i Arsimit - Gjirokastër, Dh. Gjerga, drejtuar Ministrisë së Arsimit, 29 shtator 1934.

[40] *Po aty*, fl.208. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Gjirokastër, 29 shtator 1934.

[41] *Po aty*, fl.200.

në të njëjtën ditë, ajo e ndryshoi mendimin dhe i propozoi Ministrisë së Brendshme që administrata qendrore të mbante një qëndrim indiferent ndaj këtij bojkoti dhe shkollat të mbeteshin formalisht të hapura.[42] Ajo gjithashtu propozoi që gjuha greke të jepej në nivelin e duhur dhe jo me të meta, sepse kështu do të pengohej propaganda greke.[43]

Në tetor 1934, Ministria e Arsimit e shtriu mësimin e greqishtes edhe në klasat e para të shkollave fillore dhe hapi tri shkolla të reja. Kështu numri i shkollave fillore arriti në 38. Ato frekuentoheshin nga nxënësit e 56 katundeve greke. Numri i mësuesve që jepnin mësimet në greqisht arriti në 58. Prej tyre, 56 ishin ortodoksë dhe 2 myslimanë. Vetëm për këta mësues që jepnin lëndët mësimore në gjuhën greke shteti shpenzonte 121 000 fr. ari në vit.[44]

Ndërkohë të drejtat e tjera të popullsisë greke vijonin të respektoheshin me korrektësi. Kjo popullsi në prefekturën e Gjirokastrës me 144 818 banorë, arrinte në 33 271 veta. [Dropulli dhe qendra e Gjirokastrës 21.005 banorë, Saranda 2 138, Delvina 9.589, Konispoli 4 145 dhe Përmeti 394]. Ndër katundet greke, të cilat arrinin numrin 96 kishte edhe shqiptarë muhamedanë e ortodoksë.[45] Vetëm Ministria e Brendshme kishte 9 nëpunës grekë me detyra kryetarë dhe sekretarë komunash. Në Parlamentin Shqiptar ishin dy deputetë grekë.[46]

Në fillim të muajit tetor, qeveria dërgoi dy deputetët grekë Mihal Kaso dhe dr. Melo për të qetësuar situatën. Ata shprehën mendimin se burimi i kësaj lëvizjeje ishte konsullata greke dhe propozuan të zhvillonin një takim me nënkonsullin grek të Gjirokastrës. Mirëpo, prefektura kishte rezerva ndaj dobisë së këtij takimi, i cili mund të komentohej se qeveria po i lutej autoriteteve greke.[47] Për të frenuar lëvizjen që po përhapej në minoritet, autoritetet e Gjirokastrës morën në shërbimin ushtarak Jorgo Papadhopullin, njërin nga iniciatorët e kësaj

---

[42] *Po aty*, fl.210. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 29 shtator 1934.

[43] *Po aty*, fl.173. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 24 shtator 1934.

[44] *Po aty*, F. MA, V. 1934, D. 550, fl.1-4. Ministria e Arsimit drejtuar Inspektorisë së Arsimit Gjirokastër, 16 tetor 1934.

[45] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146/2, fl.36. Ministria e Punëve të Brendshme për Ministrinë e Punëve të Jashtme, 27 tetor 1934.

[46] *Po aty*.

[47] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.233. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 1 tetor 1934.

lëvizjeje. Menjëherë ndërhyri nënkonsulli grek i cili kërkoi lirimin e tij në bazë të traktatit për vendosjen e shërbimit konsullor, por autoritetet shqiptare argumentuan se ai nuk përfitonte prej këtij traktati. Pastaj nënkonsulli grek kërkoi lirimin e tij me pretendimin se ai ishte regjistruar në Universitetin e Athinës, gjë që nuk rezultoi e vërtetë.[48]

Qeveria shqiptare kishte vendosur të ecte në rrugën e zbatimit me forcë të masave të saj. Më 3 tetor, Ministria e Brendshme urdhëroi prefekturën e Gjirokastrës që të internoheshin në Lezhë organizatorët kryesorë të bojkotit të shkollave nga minoriteti grek, Vasil Shahini, sekretari i tij, Mihal Mano dhe kryeplaku i Derviçanit, Milo Stamuli.[49] Pas internimeve të para, lidhja midis katundeve greke filloi të përçahej. Në ditët e para të tetorit, nga 35 shkolla që ekzistonin në qarkun e Gjirokastrës, mësimet vazhdonin rregullisht në 19 shkolla, ndërsa në 16 të tjera, ato ishin bojkotuar. Katërmbëdhjetë prej këtyre shkollave që ishin bojkotuar, ndodheshin në fushën e Dropullit, zonë në të cilën kohët e fundit tre katunde i kishin dhënë fund bojkotimit.[50]

Ndërkohë, qeveria greke po e shtonte presionin ndaj Shqipërisë. Divizioni i Janinës kishte 5 ditë që po zhvillonte manovra në zonën kufitare dhe një aeroplan i këtij divizioni vazhdonte fluturimet në vijën e kufirit.[51] Gjithashtu, nënkonsulli grek i Sarandës i deklaroi deputetit Melo se qeveria greke nuk do të rrinte indiferente për çështjen e shkollave.[52]

Në veprim u futën edhe priftërinjtë grekë, të cilët i dhanë problemit të shkollave ngjyra fanatike fetare. Ndërsa kishin kaluar 20 ditë dhe mësuesit privatë nuk po pranonin të shlyenin gjobat e vëna, autoritetet e xhandarmërisë njoftonin se kishte filluar edhe mosbindja e rekrutëve për ushtarë. Kjo lëvizje ishte dokumentuar se po bëhej me nxitjen e

---

[48] *Po aty*, fl.238. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 2 tetor 1934.

[49] *Po aty*, fl.243. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës së Gjirokastrës, 3 tetor 1934.

[50] *Po aty*, fl.273. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 6 tetor 1934.

[51] *Po aty*, fl.256. Komanda e Kompanisë së Kufirit Jergucat drejtuar Komandës së Trupit RM të Kufirit, Tiranë, 1 tetor 1934.

[52] *Po aty*, fl.263. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 4 tetor 1934.

organizatave vorio-epirote dhe të qeverisë greke. Popullsia e minoritetit po e merrte butësinë e qeverisë si mungesë kompetence.[53]

Qeveria, për të shmangur acarimin e mëtejshëm të situatës, vijonte të bënte përpjekje që shkollat të mbaheshin të hapura dhe të funksiononin rregullisht. Në këtë kuadër, ajo pezulloi edhe urdhrin për rekrutimin e mësuesve grekë në shërbimin ushtarak.[54]

Pas disa sukseseve të ditëve të para të tetorit, në mesin e këtij muaji u duk se masat e marra nga qeveria po dështonin dhe situata në minoritet po keqësohej. Deri në mesin e tetorit ishin internuar 12 vetë nga qarku i Gjirokastrës, por nuk shihej ndonjë përmirësim i situatës së përgjithshme dhe nuk ishte rritur frekuentimi i shkollave greke. Përkundrazi, edhe në disa shkolla si ato të Pogonit, në të cilat pak ditë më parë kishin filluar mësimet, numri i nxënësve që frekuentonin shkollën ishte pakësuar dhe mendohej se pas pak ditësh, edhe ato shkolla do të mbylleshin. Shkaku thelbësor i këtij dështimi ishte veprimtaria e konsullatës greke, e cila nxiste popullsinë minoritare për mosfrekuentimin e shkollave. Madje, prefektura e Gjirokastrës kishte marrë të dhëna se, konsullata greke kishte bërë edhe kërcënime kundrejt atyre banorëve që donin t'i dërgonin fëmijët në shkollë. Ajo, madje, kishte përhapur lajme se do t'i vriste ata prindër që do të dërgonin fëmijët në shkolla dhe për këtë qëllim do të angazhonte komitë që do t'i sillte nga Greqia.[55]

Në anën tjetër, po propagandohej se qeveria greke, nëpërmjet Lidhjes së Kombeve, do t'i imponoonte medoemos qeverisë shqiptare emërimin e mësuesve privatë, siç kishin qenë më parë.

Një mjet i fortë presioni ishte edhe shtypi grek, i cili ngjallte tek minoriteti shpresën se gjendja e mëparshme do të rikthehej. Prefektura e Gjirokastrës kishte informata të sigurta se konsullata greke po u jepte personave të internuar nga 5 fr. ari në ditë, ndërsa familjeve të tyre nga 5 fr. ari të tjera në ditë për nevoja ushqimore.[56]

---

[53] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146/1, fl.35-36. Komanda e Baonit III të RM të Kufirit (Kapiten Muharrem Bajraktari) drejtuar Komandës së Trupit RM të Kufirit, Korçë, 13 tetor 1934.

[54] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146, fl.291. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Gjirokastër.

[55] *Po aty*, fl.293. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 15 tetor 1934.

[56] *Po aty*.

Iniciatorët kryesorë të propagandës për bojkotimin e shkollave ishin ish mësuesit privatë, të cilët vijonin të merrnin rroga nga Greqia, madje atyre u ishte siguruar edhe pensioni. Prefektura e Gjirokastrës vinte në dukje se këto pagesa që bënte qeveria greke kishin dobësuar efektivitetin e masave të qeverisë shqiptare dhe, për sa kohë që ato do të vazhdonin, propaganda dhe ideja greke nuk mund të zhdukej nga katundet minoritare.[57] Ajo kërkonte që ky sistem i pagesave të mësuesve, i trashëguar nga koha e Turqisë, nuk duhej të vazhdonte më tej në Shqipëri dhe për këtë propozonte marrjen e masave të rrepta. Ajo sugjeronte që disa nga ish mësuesit privatë, të cilët ishin më aktivë në propagandën greke kundër shtetit shqiptar, të dëboheshin nga Shqipëria familjarisht. Për këtë duhej zbatuar Kodi Civil, dispozitat e të cilit përcaktonin që një nënshtetas shqiptar, i cili merrte rrogë nga një shtet i huaj për një shërbim të posaçëm, e humbiste nënshtetësinë shqiptare. Në këtë mënyrë, ata mësues që merrnin rroga nga Greqia e humbnin shtetësinë dhe, kështu, në bazë të dispozitave të tjera të Kodit Civil, mund të nxirreshin jashtë shtetit si persona të padëshiruar.

Prefektura e Gjirokastrës shprehte habinë se si gjithë nëpunësit grekë të shtetit shqiptar, si mjekë, prokurorë, drejtorë etj., që kishin pozita të larta dhe shumë grekë të tjerë, fëmijët e të cilëve studionin me bursa të shtetit shqiptar brenda dhe jashtë vendit, po qëndronin indiferentë dhe nuk dëshironin të ndikonin tek miqtë dhe të afërmit e tyre për të dërguar fëmijët në shkolla.[58] Ajo propozonte që edhe ndaj tyre të merreshin masa shembullore. Në rast të kundërt nuk mund të zhdukej ideja greke në katundet minoritare, të cilët tani po kërkonin mësuesit privatë të paguar prej Greqisë dhe nesër mund të kërkonin të tjera privilegje, të cilat do të cenonin pavarësinë e Shqipërisë.

Prefektura sugjeronte që, në se interesat e shtetit kërkonin që çështja e shkollave të mbyllej pa bujë dhe që këto masa të mos merreshin, atëherë do të ishte më mirë që të mbahej një qëndrim indiferent ndaj bojkotit të shkollës prej grekëve, duke i lënë të hapura shkollat, në pritje që prindërit t'i sillnin vetë fëmijët, pasi ata nuk mund të rrinin një kohë të gjatë pa dërguar djemtë në shkollë.[59]

---

[57] *Po aty*.
[58] *Po aty*.
[59] *Po aty*.

Lajmet për protestën e grekëve në Lidhjen e Kombeve dhe për bojkotimin e shkollave prej tyre u përcollën me indinjatë nga popullsia shqiptare e prefekturës së Gjirokastrës. Po bëheshin përpjekje për të organizuar një miting në Gjirokastër kundër kësaj lëvizjeje greke. Qeveria, e shqetësuar se mund të acaroheshin marrëdhëniet me Greqinë, u përpoq ta ndalonte mitingun por nuk mundi, megjithëse mobilizoi një fuqi prej 200 xhandarësh. Prefektura e Gjirokastrës informonte autoritetet qendrore: "U përpoqëm që më parë ta pengonim organizimin e mitingut, por pa rezultat. Populli nuk u bind. Organizatorët e tij deklaruan se, edhe pse qeveria nuk dëshiron që të bëhet mitingu, populli, medoemos do të vijë në Gjirokastër, për të bërë demonstratë". Pas kësaj, autoritetet qendrore u përpoqën që, të paktën, ta mbanin nën kontroll situatën. Ato u dhanë porosi të rrepta autoriteteve vendore që oratorët e mitingut të mos lejoheshin të shpreheshin me fjalë fyese për Greqinë, për minoritetin grek dhe për konsullatën greke por mund të flisnin kundër vorio-epirotëve.[60] Gjithashtu, qeveria kërkoi të ndikohej tek organizatorët që mitingu ta trajtonte çështjen e shkollave si një çështje të brendshme të Shqipërisë që do të zgjidhej nga qeveria shqiptare. Prej tij parashikohej t'i dërgohej një telegram Lidhjes së Kombeve, në të cilin do të dënoheshin protestat e vorio-epirotëve dhe do të theksohej se minoriteti grek në Shqipëri po trajtohej mirë.[61]

Në krye të organizatorëve të këtij demonstrimi ishte Avni Delvina. Në miting morën pjesë 2.000-3.000 veta. Midis xhandarmërisë dhe demonstruesve pati përleshje, madje edhe të plagosur e të gjakosur. Protestuesit u mblodhën në sheshin “Çerçiz Topulli” dhe hodhën parullat: "Rroftë Shqipëria", "Rroftë Pavarësia dhe Sovrani jonë August". Oratorët e tij ishin Vangjel Koça e Xhevat Kallajxhiu. Fjalimet që u mbajtën në miting ishin me tone këshilluese e të urta. Ata evokuan "vëllazërinë që ekzistonte midis popullit shqiptar dhe grekëve të Shqipërisë, por dënuan veprimtarinë e sillogjeve vorio-epirote".[62]

Qeveria dëshironte ta zgjidhte çështjen e shkollave me anë të një marrëveshjeje të drejtpërdrejtë me përfaqësuesit e minoritetit me qëllim që të shmangte si ndërhyrjen e qeverisë greke ashtu edhe angazhimin e

---

[60] *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 146/1, fl.30. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Gjirokastër, 20 tetor 1934.

[61] *Po aty*.

[62] *Po aty*, fl.52. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 24 tetor 1934.

mëtejshëm të Lidhjes së Kombeve në këtë çështje. Ajo bëri përpjekje që të krijohej një komision i katundeve greke, i cili do të shkonte në Tiranë për bisedime me përfaqësuesit e saj, por, po ndeshte vështirësi në krijimin e tij.[63] Në fakt, në Libohovë, popullsia e katundeve greke zhvilloi dy mbledhje për zgjedhjen e personave që do të shkonin në Tiranë, por ato përfunduan pa sukses. Arritjen e tij e pengoi në njërën anë, konsullata greke dhe në anën tjetër, ardhja e deputetëve të Gjirokastrës për të biseduar me popullsinë greke. Kështu, popullsia ndryshoi mendim për dërgimin e komisionit në Tiranë, duke pretenduar se dëshirat dhe kushtet e tyre ua kishin parashtruar deputetëve. Në këtë mënyrë, vajtja e deputetëve në fshatrat greke e inkurajoi më tepër kundërshtimin e popullsisë. Ajo e interpretoi vizitën e tyre si një dobësi të qeverisë, e cila po dërgonte personalitete që të hynin në marrëveshje me ta.[64] Nënprefektura e Delvinës njoftoi se Hiqmet Delvina dhe dr. Melo ishin takuar me një përfaqësi të grekëve, e cila kishte kërkuar mësimin e greqishtes rregullisht, mësimin e besimit në greqisht dhe të drejtën e inspektimit mbi mësuesit nga ana e katundeve. Në qoftë se realizoheshin këto kërkesa, marrëveshja do të arrihej. Ndërsa shpresat ishin shumë të pakta për arritjen e një marrëveshjeje me katundet greke të Gjirokastrës.[65] Ndërkohë, sekretari i konsullatës greke të Sarandës po vazhdonte hapur propagandën në Delvinë për të kundërshtuar çdo kompromis dhe marrëveshje me qeverinë shqiptare.

Në fund të tetorit, qeveria dha porosi që autoritetet vendore të mbanin qëndrim indiferent ndaj nxënësve që nuk frekuentonin shkollën. Shkollat do të konsideroheshin të hapura. Autoritetet shtetërore dhanë porosi që mësimi të zhvillohej me cilësi të lartë dhe me korrektësi në shkollat që funksiononin, në mënyrë që populli ta kuptonte se qeveria e kishte marrë seriozisht dhe me sinqeritet zhvillimin e arsimit në minoritet. Gjithashtu, një qëndrim indiferent do të mbahej edhe për çështjen e formimit të komisionit të minoritetit, i cili ishte paraparë që të zhvillonte bisedime në Tiranë.[66]

---

[63] *Po aty*, fl.61. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 27 tetor 1934.

[64] *Po aty*, fl.72. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 29 tetor 1934.

[65] *Po aty*, fl.70. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 29 tetor 1934.

[66] *Po aty*, fl.85. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Gjirokastër, 31 tetor 1934.

Për ta përforcuar lëvizjen për bojkotimin e shkollave, konsullata greke e Gjirokastrës dhe nënkonsullata e Sarandës, në ditët e para të nëntorit, përhapën lajmin se së shpejti do të vinte një Komision i Lidhjes së Kombeve dhe se qeveria greke i kishte marrë të gjitha masat për hapjen e shkollave greke. Konsujt grekë arritën të ndalonin dërgimin e komisionit përfaqësues të minoritetit në Tiranë.[67] Konsullata greke dërgoi njerëz edhe në Himarë për të organizuar aty nënshkrimin e një proteste që do t'i dërgohej Lidhjes së Kombeve për problemin e shkollave greke dhe për të nxitur bojkotimin e shkollave.[68] Ndërsa mësuesit zyrtarë të shkollave greke ishin të alarmuar dhe ndjeheshin të kërcënuar nga lajmet e përhapura për organizimin e çetave të andartëve vorio-epirotë përtej kufirit dhe për mundësinë e futjes së tyre në territorin shqiptar.[69]

Në këtë kohë, Ministria e Arsimit bëri një lëshim të rëndësishëm. Ajo urdhëroi që mësimi i të gjitha lëndëve në shkollat greke të zhvillohej vetëm në gjuhën greke.[70] Në këtë mënyrë ajo korrigjoi masat me karakter nacionalist që kishte marrë më parë për kufizimin e orëve të mësimit në greqisht në shkollat greke. Tashmë qeveria shqiptare mendonte se ishte në pozita më të forta për të kundërshtuar në opinionin ndërkombëtar kërkesat e tjera të minoritetit grek. Ministri i Jashtëm Xhafer Vila, u deklaroi agjencive të huaja[71] se ankimi i bërë në emër të pakicës greke ishte rezultat i influencës së jashtme greke dhe se "asnjë vend nuk i përmbushte me kaq respekt obligimet ndaj pakicave se sa Shqipëria", e cila "kurrë nuk i kishte shkelur angazhimet për minoritetet që kishte marrë në Lidhjen e Kombeve, sepse ajo synonte t'i shtonte shkollat e gjuhës greke". Ai deklaroi se komunitetet greke më parë kishin pasur 50 shkolla, mësuesit e të cilave nuk paguheshin prej këtyre komuniteteve të varfra, por prej Greqisë dhe zhvillonin propagandë politike në favor të saj në këto shkolla. Me reformën arsimore, qeveria shqiptare i kishte zëvendësuar këta mësues me ata që dinin mirë gjuhën greke dhe me

[67] *Po aty*, fl.110. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 6 nëntor 1934.

[68] *Po aty*, fl.105. Prefektura Gjirokastër drejtuar nënprefekturës Himarë, 6 nëntor 1934.

[69] *Po aty*, fl.122. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 6 nëntor 1934.

[70] *Po aty*, fl.125. Ministria e Arsimit për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 7 nëntor 1934.

[71] *AMPJ*, V. 1934, D. 255, fl.121. Deklaratë e ministrit të Jashtëm, Xhafer Vila, dhënë agjencive të huaja.

përkatësi fetare ortodokse, të cilët i kishin kryer që të gjithë shkollat në Greqi. Të gjitha lëndët mësoheshin në gjuhën greke dhe vetëm një orë mësimi në ditë jepej në gjuhën shqipe, si gjuhë e dytë. Shkollat që tashmë ishin publike, arrinin numrin 40 dhe do të shtoheshin për të arritur numrin e mëparshëm 50, sapo të sigurohej personeli i përshtatshëm. Vila deklaronte se, konsujt grekë që vepronin në këto vise kishin arritur, me bindje e me frikësime, të shkaktonin një grevë shkollore në këto shkolla, gjë që ishte shumë dëshpëruese. Ai polemizonte se pakica shqiptare në Greqi, që arrinte në 30 mijë banorë, nuk gëzonte asnjë të drejtë, as përfaqësim politik, as nuk kishte zyrtarë në shtetin grek dhe asnjë shkollë të saj në gjuhën shqipe.[72]

Mirëpo edhe kjo masë e re, pra zhvillimi i gjithë lëndëve në gjuhën greke, megjithëse plotësonte qëllimin themelor të shkollës për mësimin e nxënësve në gjuhën amtare, nuk solli rezultatin e dëshiruar të shtimit të nxënësve në shkolla. Me sa dukej, popullsia minoritare priste udhëzimet e mëtejshme të konsullatës greke dhe nuk ishte tërhequr nga synimi për të rihapur shkollat private greke.[73]

Në një takim që bënë zyrtarët e komunës së Dhrovjanit me parinë e fshatrave Leshnicë e Poshtme dhe e Sipërme, këto të fundit deklaruan se popullsia e këtyre katundeve e kishte pritur me kënaqësi zhvillimin e mësimeve në gjuhën greke, por e quajtën këtë masë të pamjaftueshme. Ata kërkuan që të plotësoheshin kërkesat që u kishin parashtruar më parë deputetëve Hiqmet Delvina e Jani Melo që të kishin të drejtë të zgjidhnin vetë personelin arsimor prej ish mësuesve privatë. Të drejtat që do të akordoheshin të përcaktoheshin me ligj, i cili do të njihej prej Lidhjes së Kombeve. Komisioni që do të zgjidhej prej katundeve si kujdestar i kishës dhe i pasurisë kolektive, të kishte të drejtë të inspektonte përgatitjen e nxënësve dhe të emërohej një inspektor grek për shkollat. Pleqësitë e këtyre dy fshatrave kërkuan edhe lirimin e të internuarve dhe lejimin e dhënies së mësimeve fetare jashtë shkollës.[74]

Disa ditë më vonë u bë e qartë se masat e reja kishin dështuar. Si rezultat i ndërhyrjes së konsujve grekë, popullsia greke nuk i dërgoi fëmijët në shkolla, madje numri i atyre që frekuentonin shkollën po binte

---

[72] *Po aty*.

[73] *AQSH,* F. MPB, V. 1934, D. 146/1, fl.197. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 14 nëntor 1934.

[74] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, D. 146/1a. Komuna e Dhrovjanit drejtuar nënprefekturës së Delvinës, 15 nëntor 1934.

vazhdimisht. Ata po kërkonin me vendosmëri rihapjen e shkollave private.[75]

Nuk dhanë rezultat as përpjekjet e imzot Kisit i cili, qysh kur kishte marrë në dorëzim episkopatën e Gjirokastrës, vetë, dhe nëpërmjet priftërinjve shqiptarë, ishte interesuar shumë për çështjen e shkollave dhe e kishte këshilluar popullsinë greke që të dërgonte fëmijët në shkollë.[76]

Shqetësues po bëhej edhe problemi i të internuarve. Më 15 janar 1935, çështja e shkollave greke do të diskutohej në Këshillin e Lidhjes së Kombeve dhe lirimi i tyre duhej të bëhej sa më parë, me qëllim që diskutimi të përfundonte në favor të Shqipërisë. Duke pasur këtë shqetësim, Ministria e Punëve të Brendshme ndërsa nuk kundërshtonte lirimin e tyre, njëkohësisht, nuk donte që kjo masë të merrej si dobësi e qeverisë. Prandaj ajo porositi prefekturën e Gjirokastrës të gjente një mënyrë që komuniteti grek në Shqipëri ta kuptonte se lirimi i tyre ishte vullnet i prefekturës dhe jo për shkak të presionit të grekëve ose prej konsullit grek.[77]

Edhe prefektura e Gjirokastrës e konsideronte të dëmshëm lirimin e të internuarve para se të fillonte dërgimi i nxënësve në shkolla, pasi kjo do të konsiderohej nga opinioni publik si një dobësi dhe jo si një gjest bujarie i qeverisë. Lirimin e të internuarve ia kishin kërkuar asaj prefekture, përfaqësues të popullsisë greke si dhe nënkonsulli grek i Gjirokastrës, por, ajo ishte përgjigjur se nuk mund të ndërhynte pranë autoriteteve qendrore për lirimin e tyre, pa filluar dërgimi i nxënësve në shkolla.[78] Sidoqoftë, prefektura sugjeroi që të kthehej nga Kruja, dr. Kiçati, ku qëndronte i internuar dhe, meqë ai kishte një influencë të madhe në komunën e Pogonit, t'i kërkohej që të ndihmonte në funksionimin e shkollave greke. Për ta bindur atë, do t'u kërkohej ndihma vëllezërve Vavaku, të cilët ishin nëpunës të lartë në Ministrinë e Ekonomisë Kombëtare dhe njëri prej tyre ishte dhëndëri i dr. Kiçatit.[79]

---

[75] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, fl.279. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 23 nëntor 1934.

[76] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, fl.284. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 24 nëntor 1934.

[77] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, fl.341. Ministria e Punëve të Brendshme për prefekturën Gjirokastër, 15 dhjetor 1934.

[78] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, fl.336. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 12 dhjetor 1934.

[79] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, D. 146/1a, fl.355. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 21 dhjetor 1934.

Ndërkohë, zgjatja e bojkotimit filloi të krijojë shqetësime në shumë katunde greke. Një pjesë e popullsisë dëshironte t'i dërgonte sa më parë fëmijët në shkollë por pengohej nga konsullata greke, e cila propagandonte se Lidhja e Kombeve do të merrte parasysh gjithë kërkesat e popullsisë greke dhe kërkonte vazhdimin me çdo kusht të bojkotimit të shkollave.[80] Drejtori i shkollës së Delvinës informonte se familjet e grekëve ishin penduar shumë për tërheqjen e nxënësve nga shkollat dhe po e shfaqnin hapur dëshpërimin, duke mallkuar shkaktarët e këtij rrënimi të papritur. Ai pohonte se ata, me siguri, do t'i çonin nxënësit në shkollë në qoftë se nuk do të vazhdonin të influencoheshin nga propagandistët dhe konsullata greke, të cilët po e mbanin popullsinë me shpresa se do të rihapnin shkollat private.[81]

Autoritetet shqiptare u përpoqën ta izolonin konsullatën greke. Kjo masë ndikoi që një pjesë e popullsisë të lëkundej dhe të kuptonte se konsulli i Greqisë në Shqipëri nuk ishte një njeri me fuqi të pakufizuar. Prefektura propozonte që të vazhdonte për një periudhë të gjatë izolimi i konsullatës greke, me qëllim që të bëhej e qartë se ajo nuk ishte udhëheqje politike e minoritetit grek por thjesht një agjenci tregtare e qeverisë greke.[82]

Më 22 dhjetor, Ministria e Brendshme urdhëroi lirimin e gjithë minoritarëve të internuar.[83] Ndërkohë, konsullata greke i shtoi një element të ri propagandës së saj. Tashmë konsulli grek po përhapte lajme se çështja e shkollave do të zgjidhej brenda pak ditëve me një marrëveshje miqësore midis dy shteteve, para se ajo të diskutohej në Këshillin e Lidhjes së Kombeve.

Megjithëkëtë, qeveria mori disa masa të kujdesshme për të përballuar ndonjë ndërhyrje të armatosur nga qeveria greke ose nga ekstremistët vorio-epirotë. Në fshehtësi, ajo dha porosi për regjistrimin pa bujë të vullnetarëve në prefekturën e Korçës. Ndërsa, prefektura e Elbasanit dhe ajo e Beratit informonin se oficerët rezervë të këtyre qarqeve kishin

---

[80] *Po aty,* fl.353. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 21 dhjetor 1934.

[81] *Po aty,* fl.385. Drejtori i shkollës së Delvinës, I. Kushta drejtuar Ministrisë së Arsimit, 12 janar 1935.

[82] *Po aty,* fl.353. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 21 dhjetor 1934.

[83] *Po aty,* fl.356. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Gjirokastër, 22 dhjetor 1934.

regjistruar vullnetarë edhe në zonën e Gramshit e të Skraparit, megjithëse qeveria nuk kishte dhënë udhëzime për rekrutimin e vullnetarëve nga këto zona.[84]

Fillimisht, autoritetet shqiptare ishin të shqetësuara nga mundësia e bashkëpunimit midis emigracionit politik antizogist shqiptar dhe qarqeve greke e grekomane kundër Shqipërisë. Por më vonë këto shqetësime u pakësuan. Prefektura e Gjirokastrës informonte Ministrinë e Brendshme se Koço Tasi nuk gëzonte aspak influencë midis grekëve të atij qarku dhe ata nuk mund të arrinin ndonjë marrëveshje me të për çështjen e shkollave. Gjithashtu, ajo informonte se, po të kishte qenë në fuqi partia venizelliste, ajo, me anë të klubeve vorio-epirote, mund t'i nxiste grekët dhe t'i mbante gjallë shpresat e tyre. Por, me humbjen e saj edhe grekët i kishin humbur shpresat dhe nuk prisnin ndonjë përfitim.[85]

Në fillim të janarit të vitit 1935, konsullatat greke ishin në ofensivë. Madje, ata kishin vendosur ta shfrytëzonin rastin për t'iu rikthyer politikave të vjetra për fuqizimin e helenizmit në Shqipërinë e Jugut. Agjentët e tyre, duke marrë si shkak mungesën e mësimit të besimit në shkolla, po propagandonin dhe nxisnin që edhe shqiptarët e qarkut të Gjirokastrës të bashkoheshin me grevën e grekëve, me qëllim që të përfitonin nga neni 7 i Deklaratës që kishte bërë Shqipëria në Lidhjen e Kombeve.[86]

Bashkë me optimizmin dhe euforinë që kishte krijuar propaganda e drejtuar nga konsullatat greke, në zonën e minoritetit ekzistonte edhe frika se kauza e tyre nuk do të fitonte. Një lajm i përhapur në këtë kohë se çështja e shkollave do të shqyrtohej nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës dhe se në atë gjyq grekët e kishin të humbur davanë, kishte ngjallur dëshpërim në minoritet. Një pjesë e popullsisë kishte frikë se paskëtaj minoriteti do të vështrohej prej qeverisë si armik i saj. Ndërkaq, në disa katunde, arsimtarët e emëruar nga qeveria ishin në vështirësi sepse banorët grekë nuk u kishin dhënë strehim dhe ua shisnin ushqimet me çmime tepër të larta.[87]

---

[84] *Po aty,* F. MPB, V. 1934, D. 146/2, fl.186. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Korçë, 4 janar 1935.

[85] *Po aty,* F. MPB, V. 1935, D. 302, fl.11. Prefektura e Gjirokastrës për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 25 maj 1935.

[86] *Po aty,* F. MA, V. 1935, D. 51, fl.2. Drejtori i shkollës së Libohovës, N. Roshi drejtuar Ministrisë së Arsimit, 2 janar 1935.

[87] *Po aty,* fl.16. Inspektori i Arsimit në Delvinë drejtuar Ministrisë së Arsimit, 4 shkurt 1935.

Në qendër të Delvinës familjet ortodokse ishin penduar shumë për tërheqjen e nxënësve nga shkollat dhe po e shfaqnin hapur dëshpërimin, duke mallkuar shkaktarët e këtij rrënimi të papritur. Ata ishin të disponuar t'i çonin nxënësit në shkollë por ishin nën influencën dhe nën presionin e propagandistëve të organizatave vorio-epirote, të cilët po bënin çmos që të shtonin kurajën e popullsisë.[88] Në mesin e janarit edhe prefektura e Gjirokastrës informoi se në shumë katunde greke ishte krijuar një pakënaqësi ndaj propagandës dhe premtimeve të konsullatës greke.

Pasi u liruan të internuarit popullsia mendoi se do të merrte fund çështja e shkollave. Por, kur kjo nuk ndodhi, në shumë katunde popullsia u nda në dysh. Shumica e saj shfaqte pakënaqësi sepse nuk ishin realizuar premtimet e konsullatës. Në anën tjetër qëndronin ish mësuesit privatë, të cilët këmbëngulnin në qëndrimin e tyre. Prefektura e Gjirokastrës mendonte se në këtë situatë, organet shtetërore duhej të qëndronin indiferente, pasi pritej që përçarja midis dy palëve të thellohej dhe, më tej, nxënësit mund të fillonin frekuentimin e shkollave shtetërore.[89]

Në mesin e muajit janar u shtrua në Këshillin e LK çështja e mbrojtjes së pakicave në Shqipëri. Relatori i çështjes, përfaqësuesi i Spanjës, Madariaga, parashtroi Statutin e Shqipërisë që i jepte shtetit të drejtën e arsimit dhe shtoi se, sipas Deklaratës së vitit 1921, Shqipëria u lejonte pakicave të mbanin shkollat e veta. Pikëpamjen shqiptare e mbrojti Mehdi Frashëri, i cili mbajti një fjalim të gjatë dhe përmendi argumente të ndryshme. U vendos që kjo çështje të studiohej prej Këshillit të LK, pasi të paraqitej raporti përkatës i Madariagës.[90] Më tej, çështja iu referua Gjykatës së Hagës.[91] Megjithëkëtë ata nuk po i dërgonin fëmijët në shkolla sepse konsullata greke u kishte thënë që shkollat duheshin bojkotuar derisa Këshilli i LK të merrte vendimin

[88] *Po aty,* fl.4. Drejtori i shkollës së Delvinës, I. Kushta, për Ministrinë e Arsimit, 12 janar 1935.

[89] *Po aty,* F. MPB, V. 1935, D. 399, fl.15-16. Prefektura e Gjirokastrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 15 janar 1935.

[90] "Çështja e shkollave grekofone filloi të bisedohet prej LK", *Gazeta e Korçës*, Korçë, 18 janar 1935.

[91] *AQSH*, F. MPB, V. 1935, D. 399, fl.22. Drejtori i shkollës në Delvinë, I. Kushta, për Ministrinë e Arsimit, 20 janar 1935.

përfundimtar. Ajo i siguroi grekët se qeveria në Athinë po e ndiqte dhe do ta ndiqte këtë çështje me energjinë më të madhe.[92]

Nga ana tjetër, Ministria e Arsimit po vijonte përpjekjet për të kënaqur popullsinë minoritare, duke zgjeruar rrjetin e shkollave në shumicën dërrmuese të katundeve greke. Pa shkolla kishin mbetur 39 katunde me një popullsi prej 7 288 banorësh, e cila përbënte një të pestën e numrit të përgjithshëm të popullsisë greke të Shqipërisë. Arsyeja ishte se këto katunde kishin shumë pak nxënës. Shumica e tyre kishte 10 nxënës ose edhe më pak dhe, nga që ndodheshin larg me njëri-tjetrin, nuk kishte qenë e mundur të bashkoheshin në një shkollë. Ministria e Arsimit, duke u bazuar në ligjin e ri, parashikonte që vitin e ardhshëm shkollor të zbatonte masa të reja që, disa prej këtyre katundeve t'u siguronte mësimin tërësisht në gjuhën greke.[93]

Gjatë muajit shkurt 1935, u shtua komunikimi i mësuesve privatë me konsullatën greke të Sarandës. Po rezultonte se izolimi i konsullatës nuk ishte shumë i dobishëm, pasi mësuesve u shpërndaheshin rrogat nga tregtarët grekë. Sidoqoftë ky veprim kishte ndikuar që të binte disi influenca e saj tek popullsia minoritare.[94] Bojkoti gjithsesi do të vijonte deri në vendimin që do të merrte disa javë më vonë, Gjykata e Hagës.

Deri në këtë periudhë gjendja në zonën e minoritetit dhe raportet e tij me qeverinë shqiptare mbetën të ndera. Kjo ishte një nga periudhat e pakta që këto raporte kishin qenë të tilla, pasi ato më parë kishin qenë më të qeta. Qeveria shqiptare përmes shtetëzimit u përpoq të eliminonte dy probleme serioze në marrëdhëniet me minoritetin grek: 1. Ndërhyrjen e qeverisë greke dhe instrumentalizimin e popullsisë minoritare përmes propagandës që bënin mësuesit e shkollave private minoritare, programeve dhe përmbajtjes së lëndëve mësimore; 2. Integrimin e popullsisë minoritare në shtetin dhe shoqërinë shqiptare, duke ruajtur identitetin kombëtar të kësaj popullsie. Të dyja këto synime ishin legjitime por shtetëzimi i shkollave rezultoi shumë i vështirë dhe konfliktual, duke nxjerrë në pah edhe dobësitë që kishte shteti shqiptar në arenën ndërkombëtare por edhe brenda vendit.

---

[92] *Po aty,* fl.33. Prefektura Gjirokastër drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 28 janar 1935.

[93] *AMPJ*, V. 1935, D. 297, fl.25. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 4 shkurt 1935.

[94] *AQSH*, F. MPB, V. 1935, D. 399, fl.63. Prefektura Gjirokastër për Ministrinë e Punëve të Brendshme, 28 shkurt 1935.

Summary

NATURALIZATION OF GREEK PRIVATE SCHOOLS AND MINORITY REACTION

In April 1933, the Albanian government decided to ban private education in Albania, putting it under the control of the Albanian state. This measure also affected the private minority schools in Albania, in which the number of pupils was very small. However schools in the Greek minority area were more numerous than in other areas of the country. The Ministry of Education of Albania fired Greek language teachers who did not know Albanian and those who did not have the relevant education. The only criticism that could be leveled at these measures was the reduction of Greek language teaching hours, initially to 4 and then to 6 hours per week.

In the first steps, the resistance of the Greek minority population was passive. In early 1934, the problem of schools began to become more acute. The promoters of this movement were, as always, the Greek consulates. The Greek consul of Gjirokastra had instructed the elders of some Greek villages that the schools would be opened with weapons and that "we are able to cut up the whole of Albania, if it does not meet our demands." The complaint that the Greeks addressed to the League of Nations stated that the number of Greek schools closed was 350. In fact, this was a falsification.

Under strong external pressure, the Albanian Ministry of Education began to make concessions. Initially, it authorized the teaching of the Greek language in 13 other primary schools of the Greek minority. Shortly afterwards, the Albanian Ministry of Education made a significant release. She ordered that the teaching of all subjects in Greek schools be conducted only in the Greek language.

In mid-January 1935, the issue of the protection of minorities in Albania was raised in the Council of the League of Nations. The case was further referred to the International Court of Justice in The Hague. The boycott of teaching by students from Greek minority villages would nevertheless continue until a decision was made a few weeks later by the Hague Tribunal.